



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.3.2023

Nr: 223

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË RADIO TELEVISIONIT ORA NEWS, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 30.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Radio Televizionit Ora News,
Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.76, ish- Kinostudio "Shqipëria e Re", me seli në Tiranë.

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi i gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave"

Data: 30.3.2023

Nr: 223
Ora: 11:00



"Për shqyrtimin e kërkesës së Radio Televizionit Ora News, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023".

V Ë R E J:

Radio Televizioni Ora News, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) gazetarë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Radio Televizioni Ora News është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e Kodit Zgjedhor.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S:

1. Akreditimin si përfaqësues të Medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) gazetarëve të Radio Televizionit Ora News, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI